



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 28.12.2022

**PËR**  
**KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTEVE:**  
**“GODINA NR.1 (3 KATE + 1 KAT NËNTOKË), GODINA NR.3 (6 KATE + 1 KAT**  
**NËNTOKË)”, AQUAPARK DHE PISHINA, TË NDËRTUARA BRENDË “KOMPLEKSIT**  
**TURISTIK “PRESTIGE HOLIDAY RESORT”,**  
**ME ADRESË NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM, BASHKIA KAVAJË**

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Konfiskimin për interes publik të objekteve “Godina Nr.1 (3 kate + 1 kat nëntokë), Godina Nr.3 (6 kate + 1 kat nëntokë), Aquapark dhe Pishina”, të cilët janë ndërtuar pa u pajisur me Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, brenda objektit “Kompleksi Turistik “Prestige Holiday Resort”, me adresë Njësia Administrative Golem, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Erjoni” sh.p.k.
2. Planvendosja e objekteve të konfiskuara, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi i objekteve që konfiskohen.



5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Kavajë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Kavajë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**MINISTËR I BRENDSHËM**

**BLEDAR ÇUÇI**



**ANËTAR**

**MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË**

**DELINA IBRAHIMAJ**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

